




This project is funded by the
European Union



Instituti kërkimor Demokraci për Zhvillim
Seria: Interesi publik | Nr. 22 | Prishtinë, 2021 |

Administrata Komunale në Mitrovicën e Jugut

Reforma si mekanizëm i zhvillimit



Democracy for Development
Demokraci për zhvillim
Demokratija za razvoj

Administrata Komunale në Mitrovicën e Jugut

Reforma si mekanizëm i zhvillimit

Prishtinë, tetor 2021

Të drejtat e autorit ©2021. Demokracia për Zhvillim (D4D).

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç citimeve të pasazheve të shkurtra me qëllim të kritikës dhe rishikimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të rikthimit të të dhënave, ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjete, elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar ose tjetër, pa lejen paraprake të D4D.

Punim i përgatitur nga:

Instituti Demokraci për Zhvillim

Ky raport është publikuar nga Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) në kuadër të projektit “Avokimi si katalizator për reformën e administratës publike”, që financohet nga Bashkimi Evropian, përfaqësuar nga Komisioni Evropian përmes projektit “Fuqizimi i Shoqërisë Civile të Ballkanit Perëndimor për një Administratë Publike të Reformuar” – WeBER 2.0. që menaxhohet nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) për Kosovë.

Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e Institutit Demokraci për Zhvillim dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e Bashkimit Evropian.

Tabela e përmbajtjes

Hyrje	6
Parimet e administratës publike.....	8
Korniza ligjore për funksionimin e administratës komunale	
Profili i Komunës së Mitrovicës së Jugut	11
Performanca financiare e Komunës së Mitrovicës	15
Transparenca Financiare	20
Opinionet e qytetarëve dhe zyrtarëve komunal.....	21
Zyra Kombëtare e Auditimit	23
Rekomandimet.....	25

Lista e tabelave

Tabela 1. Planifikimi i buxhetit për vitet 2019 dhe 2020.	16
Tabela 2. Ndarja e buxhetit në përqindje.	17
Tabela 3. Shpenzimet e buxhetit për vitin 2019 dhe 2020. .	19
Tabela 4. Buxheti i Komunës për vitin 2019 dhe 2020.	23

Hyrje

Reformat në përgjithësi janë veprime që ndërmerren për të ndryshuar apo korrigjuar ndonjë organizatë, sistem apo të ngjashme.

Reforma e administratës publike në Kosovë është kërkuar në vazhdimësi në nivelin nacional. Qëllimi i këtij punimi është më specifik, dhe tenton të analizoj nëse është e nevojshme që të ketë reformë të administratës në nivelin lokal dhe me specifikisht në komunën e Mitrovicës. Pasi që reforma e pushtetit lokal në Kosovë mund të konsiderohet si një veprim i cili duhet të merret nga niveli qendrorë që është edhe kompetence e tij, në këtë punim fokusi do të jetë se çfarë mund të bëjë niveli lokal, konkretisht komuna, brenda kornizës aktuale ligjore në përmirësimin e shërbimeve që ofrohen dhe janë kompetencë e komunës.

Për të kuptuar nevojat e intervenimit që duhet ndërmerren sa i përket funksionimit më të mirë të administratës publike në nivelin lokal, ky punim analizon punën e administratës komunale të Mitrovicës në dy vitet e fundit, 2019-2020. Vlerësimi i punës dhe nevojës për reformë apo për intervenime të nevojshme që të përmirësohen shërbimet e komunës është bërë duke vlerësuar raportet e ndryshme të organizatave të ndryshme për Komunën e Mitrovicës, intervistat me zyrtarë të komunës, raportet e auditorit të përgjithshëm, intervista me anëtar/e të Kuvendit të Komunës si dhe me qytetarë të Komunës së Mitrovicës.

Për të kuptuar më mirë kontekstin e reformës, ky punim së pari paraqet profilin e Komunës së Mitrovicës në pika të shkurta, parimet kryesore të funksionimit të administratës publike, vlerësimet zyrtare dhe jozyrtare përmes raporteve të institucioneve shtetërore dhe organizatave joqeveritare për punën e administratës në Komunën e Mitrovicës si dhe vlerësimin subjektiv të zyrtarëve komunal dhe qytetarëve lidhur me ofrimin e shërbimeve të Komunës. Bazuar në këto

informata nxjerrën konkluzionet e nevojshme së bashku me rekomandimet lidhur me përmirësimin e funksionimit të administratës lokale si dhe ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët e Mitrovicës.

Parimet e administratës publike

Parimet e qeverisjes së mirë ndër të tjera kanë të bëjnë me procesin më të mirë të mundshëm të marrjes së vendimeve si dhe me kontributin dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e marrjes dhe zbatimit të vendimeve. Përveç institucioneve qeverisëse akterët tjerë që janë të përfshirë në qeverisjen lokale janë edhe qytetarët, organizatat e shoqërisë civile, mediat, bizneset, sindikatat, shoqatat e ndryshme, partitë politike etj. Roli aktiv i këtyre grupeve ndihmon në mirëqeverisjen e një komune.

Parimet kryesore të qeverisjes së mirë ndërlidhen me zgjedhjet e drejta dhe të lira, pjesëmarrjen e gjerë e të gjitha grupeve të interes, qeverisje lokale efektive dhe efikase, përgjegjshmëri, llogaridhënie, sjellje etike dhe respektim të sundimit të ligjit, menaxhimit të mirë financiar, transparencës, respektimit të të drejtave të njeriut si dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.

Parimet bazë të vetëqeverisjes lokale (VQL) në Kosovë janë caktuar me nenin 123 të Kushtetutës, pika 4 që thotë se *‘Vetëqeverisja lokale bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike, duke u kushtuar kujdes të veçantë nevojave dhe brengave specifike të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe pjesëtarëve të tyre.’*¹ Gjithashtu Karta Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale është marrë si bazë e rëndësishme për parimet e vetëqeverisjes lokale që janë inkorporuar në Kushtetutën e Kosovës si dhe në ligjet tjera që rregullojnë fushën e vetëqeverisjes lokale.

Vetëqeverisja dhe administrata publike lokale synojnë ofrimin e shërbimeve sa më të mira dhe sa më afër qytetarëve. Duke qenë sa më afër komunitetit, qeveritë

¹ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, <https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>, Neni 123, pika 4.

lokale identifikojnë më lehtë dhe më shpejtë problemet e komunitetit dhe brenda kompetencave të tyre edhe të intervenojnë. Të qenit sa më afër komunitetit rritë efikasitetin e qeverive lokale.

Planifikimi i buxhetit nga qeveria lokale bëhet në bashkëpunim me komunitetin përmes dëgjimeve buxhetore duke marrë parasysh nevojat e tyre si dhe planifikimin e qeverive lokale dhe vizionit të tyre zhvillimor për komunën përkatëse. Si proces dëgjimet buxhetore organizohen disa herë brenda vitit ku pjesëmarrës janë edhe qytetarët e komunës për të dhënë vërejtjet e tyre si dhe rekomandimet të cilat më pas vlerësohen nga komuna dhe sipas vlerësimit të tyre mund të inkorporohen në buxhetin final të komunës.

Korniza ligjore për funksionimin e administratës komunale

Korniza ligjore që përcakton kompetencat dhe përgjegjësitë e autoriteteve lokale janë të rregulluara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës si dhe me ligjet tjera specifike.

Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, komuna është njëësia themelore e vetëqeverisjes lokale dhe niveli i vetëm i pushtetit pas atij qendrorë që drejtpërdrejtë menaxhon dhe implementon politikat lokale në të mirë të qytetarëve të komunës.

Ligji për Vetëqeverisje Lokale është ligj organik ose ligji bazë i cili organizon mënyrën e funksionimit të vetëqeverisjes lokale. Sipas LVL komunat kanë pushtetin vetanak, pushtetin e deleguar nga niveli qendrorë si dhe pushtetin e zgjeruar për disa komuna të cilat nuk mund të transferohen te ndonjë subjekt tjetër. ²

² Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr.03/L-040, <https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

Me ligje specifike janë rregulluar shumë fusha specifike që i përkasin pushtetit lokal si krijimi i komunave dhe kufijtë administrativë komunal, organizimi i zgjedhjeve lokale, menaxhimi i financave lokale si dhe shfrytëzimi i tokës dhe menaxhimi i kompanive publike rajonale.

Komunat kanë përgjegjësitë e tyre direkte si dhe kompetencë ekskluzive për të menaxhuar më një numër të shërbimeve publike që janë në interes të drejtpërdrejtë të qytetarëve të komunës përkatëse.

Organizimi politik përfaqësues i komunave është rregulluar me këtë ligj si dhe me ligjin për zgjedhjet lokale ku Kryetari i Komunës zgjidhet drejtpërdrejtë nga qytetarët dhe është ekzekutivi i komunës me kompetenca të plota në menaxhimin e Komunës si dhe Kuvendi i Komunës që e mbikëqyrë punën e Kryetarit.

Kuvendi i Komunës aprovon statutin dhe rregulloren e punës që përcakton specifikat organizative dhe funksionale për secilën komunë.

Financimi i komunave bëhet sipas ligjit ku sipas një formule të caktuar secila komunë përfiton grantin nga niveli qendrorë si dhe i sigurohen të hyrat vetanake.³

Nga niveli qendrorë komuna pranon grantin e përgjithshëm, grantin specifik për arsim si dhe grantin specifik për shëndetësi.⁴

Komunat kanë një nivel autonomie në menaxhimin e financave lokale të cilat specifikisht janë të inkorporuara në ligjin për financat e pushtetit lokal. Komunat sa i përket të hyrave vetanake kanë autonomi të plotë në vendosjen se si i shpenzojnë ato përderisa granti qeveritar në masë të madhe

³ Gazeta Zyrtare e Republikës ë Kosovës ,Ligji 03/L/049, për Financat e Pushtetit Lokal, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2525>

⁴ Gazeta Zyrtare e Republikës ë Kosovës , ,Ligji 03/L/049, për Financat e Pushtetit Lokal, Neni 23, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2525>

dedikohet për çështje të caktuara për nevojat themelore të funksionimit të Komunës ku vetëm një pjesë e grantit qeveritar mund të drejtohet në projekte të caktuara apo shpenzohet sipas kërkesës specifike të komunës.

MAPL është institucioni kryesorë që mbikëqyrë punën e organeve lokale por jo vetëm pasi që edhe ministritë e linjës kanë rol mbikëqyrës në fushën e tyre kur vie te implementimi i politikave lokale nga organet lokale.

Përmes udhëzimeve administrative të aprovuara nga MAPL dhe nga Ministritë e linjës janë rregulluar shumë fusha që duhet të implementohen edhe nga pushteti lokal.

Ligji për Shërbimin Civil është një ligj shumë më rëndësi pasi përcakton se kush është shërbyes civil, përcakton të drejtat e tyre, rregullon procesin e rekrutimit dhe avancimit në pozitë si dhe përcakton mekanizmat për vlerësimin apo edhe largimin nga puna të nënpunësve civil.⁵

Profili i Komunës së Mitrovicës së Jugut

Komuna e Mitrovicës së Jugut është njësi administrative që shtrihet në pjesën veriore të Kosovës. Sipas regjistrimit të vitit 2011 në Mitrovicën e Jugut jetonin 71.601 banorë derisa sipas vlerësimeve të ASK, në vitin 2020 në Mitrovicën e Jugut jetojnë 69,311 banorë, që gravitojnë në qytetin e Mitrovicës si qendra e vetme urbane në këtë komunë si dhe në 46 fshatrat e sajë. ⁶ Qyteti i Mitrovicës është një ndër shtatë qendrat kryesore në Republikën e Kosovës. Buxheti për vitin 2019 ka qenë 19,7 milion euro përdërisa në vitin 2020 buxheti ka arritur vlerën e 22,1 milion euro⁷. Burimi

⁵ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/L-149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2679>

⁶ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Vlerësim Popullsia e KOSOVËS 2020, <https://ask.rks-gov.net/media/6202/vler%C3%ABsimi-i-popullsis%C3%AB-2020.pdf>.

⁷ Ministria e Financave Punës dhe Transferëve, Ligji Nr. 06/L-133, <https://mf.rks->

kryesor i të hyrave së buxhetit të komunës është granti qeveritar përderisa të ardhurat vetanake të komunës janë shumë të ulta. Shpenzimet kryesore të buxhetit të Mitrovicës janë për paga dhe mëditje që shkon mbi 50% të totalit përderisa rreth 20% shkojnë si investime kapitale.⁸

Numri i votuesve të regjistruar në Komunën e Mitrovicës sipas KQZ është 79,042. Numri më i lartë i votuesve sesa numri i qytetarëve në përgjithësi ka të bëjë me legjislacionin zgjedhor i cili si votues numëron edhe banoret e Mitrovicës së Jugut që jetojnë jashtë Mitrovicës respektivisht jashtë Kosovës përderisa numri i banorëve sipas ASK-së paraqet banoret rezident në Komunën e Mitrovicës në kohën kur është bërë regjistrimi i popullsisë.

Numri i familjeve që marrin ndihmë sociale nga Komuna e Mitrovicës së Jugut në dhjetor të vitit 2020 ishte 2,392 me 9930 anëtarë që i bie se 14.3% të qytetarëve të Mitrovicës jetojnë nga ndihmat sociale. Në total duke përfshirë të gjitha skemat pensionale, përfitimet e ndryshme nga niveli qendrorë dhe ndihmat sociale janë rreth 25,600 persona që marrin përfitime financiare nga këto skema apo rreth 37% të numrit të përgjithshëm të qytetarëve të Mitrovicës.⁹

Komuna e Mitrovicës së Jugut ka të punësuar 298 shërbyes civil. Numri i bizneseve aktive në Mitrovicë arrin numrin e 4,178 ku janë të punësuar rreth 9,217 persona përderisa në sektorin publik janë të punësuar rreth 1,999 persona.¹⁰

Arsimin fillor në vitin shkollor 2019/2020 e kanë ndjekur

gov.net/desk/inc/media/4CEFBA4C-4397-4901-AB93-2AA37F43A9F7.pdf, Ligji Nr. 07/L-001, <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/23991BEA-4CD9-40B3-94D3-EA192C572464.pdf>

⁸ Ibid

⁹ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat Sociale TM4 2020, <https://ask.rks-gov.net/media/5983/statistikat-e-mir%C3%ABqenies-sociale-tm4-2020.pdf>

¹⁰ GAP, Letërnjoftimi I komunave, Mitrovica e Jugut, <https://www.komunat.institutigap.org/Files/mitrovice/2021/Let%C3%ABrnjoftim%20i%20Komun%C3%ABs%20s%C3%AB%20Mitrovic%C3%ABs%20s%C3%AB%20Jugut%20-%202021.pdf>

rreth 10,613 nxënës derisa në vitin shkollor 2020/21 ky numër ka rënë në 10,359 përderisa në arsimin e mesëm në shkolla profesionale dhe gjimnaze në vitin 19/20 janë regjistruar rreth 14,752 nxënës në vitin 2020/2021 numri ka rënë në 3,886.¹¹ Numri i mësimdhënësve në vitin 2020/2021 është 1,072 personel administrative janë 110 të punësuar derisa personel ndihmës janë 159 të punësuar.¹² Institucionet arsimore në Mitrovicë janë gjithsej 46, prej tyre 1 parashkollorë, 39 institucione të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët si dhe 6 institucione arsimore të arsimit të mesëm të lartë.

Shëndetësia në Komunën e Mitrovicës është e organizuar në shëndetësinë primare dhe në spitalin e përgjithshëm të Mitrovicës. Shëndetësia primare është e organizuar dhe përbëhet nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF), 10 Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) si dhe 12 Ambulanta të Mjekësisë Familjare.¹³ Në këto qendra punojnë gjithsej 257 punëtorë ku prej tyre janë 3 mjekë specialist, 14 mjekë të përgjithshëm dhe 22 infermierë që punojnë në poliklinikën stomatologjike përderisa në QKMF, QMF dhe AMF punojnë 17 mjekë familjarë, 137 infermier familjarë, 13 mjekë familjarë dhe 51 një punëtorë si staf tjetër.¹⁴

Ky profil i Komunës së Mitrovicës me disa të dhëna kryesore tregon për shkallën e përgjegjësisë së nivelit lokal në raport me qytetarët e komunës, shërbimeve që duhet ofruar si dhe kapacitet aktuale në disa sektorë të veçantë të komunës. Gjithashtu edhe fuqia financiare e komunës në raport me

¹¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e Arsimit në Kosovë, <https://ask.rks-gov.net/media/5636/arsimi-201920120-shqip.pdf>

¹² Ibid

¹³ Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare “Dr. Nexhat Çuni” Mitrovicë, <https://kk.rks-gov.net/mitroviceejugut/wp-content/uploads/sites/18/2021/02/Raporti-i-Punes-2020-Qendra-Kryesore-e-Mjekesise-Familjare.pdf>

¹⁴ Ibid

shërbimet që ofrohen kundrejt nevojave të qytetarëve tregon dallimin në mes të përceptimit qytetarë dhe realitetit financiar të komunës. Ky raport në mes fuqisë financiare dhe pritshmërive duhet shikuar me sy kritik pasi që nuk ka hapësirë për mrekullibërje por nevojitet një menaxhim sa më i mirë dhe efikas i buxhetit komunal në përmbushjen e objektivave qeverisëse në raport me pritshmëritë e qytetarëve.

Marrë parasysh se korniza ligjore sa i përket qeverisjes lokale nuk lejon shumë hapësirë qe komuna, e cila në masën më të madhe është e varur nga granti qeveritar, të ndër marrë hapa të mëdhenjë reformues pasiqë ato në të shumtën e rasteve përcjellen me kosto financiare të cilat komuna nuk i ka. Gjithashtu identifikimi i nevojave për reformë është një proces i cili duhet shtjelluar deri në detaje për të identifikuar se cilat reforma mund të bëhen nga qeverisja komunale pa prekur ndryshimin e ligjeve që nuk janë kompetencë e komunës. Një shembull i mirë i kësaj situate është për shembull nevoja e zgjedhjes së drejtpërdrejtë e nënkryetarit të komunës me qëllim që në rast të tërheqjes së Kryetarit të Komunës të mos shkohet menjëherë në zgjedhje por të përmbushet mandate i plotë qeverisës me nënkryetarin e zgjedhur.

Në nivelin e komunës duhet shikuar mundësinë e ndryshimeve të mundshme brenda kompetencave të pushtetit lokal sa i përket mirëqeverisjes që në shumicën e rasteve kemi të bëjmë me mirëmenaxhimin dhe implementimin e ligjeve aktuale.

Performaca financiare e Komunës së Mitrovicës

Buxheti i planifikuar për vitet 2019 dhe 2020¹⁵ dhe i aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës¹⁶ për Komunën e Mitrovicës ka qenë si në tabelat në faqen pasuese:

¹⁵ Mitrovica e Jugut, <https://kk.rks-gov.net/mitrovicееjugut/drejtoria-per-financa-dhe-zhvillim-ekonomik/buxheti/>

¹⁶ Ministria e Financave Punës dhe Transferëve, Ligji Nr. 06/L-133, <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/4CEFBA4C-4397-4901-AB93-2AA37F43A9F7.pdf>, Ligji Nr. 07/L-001, <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/23991BEA-4CD9-40B3-94D3-EA192C572464.pdf>

	Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të Komunës së Mitrovicës për vitin 2019-2021						
	Stafi	Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Subvencio ne dhe transfere	Shpenzime kapitale	Totali
<i>Shpenzimet totale komunale</i>	1973	12,025,408	2,398,883	493,815	530,043	4,280,666	19,728,815
<i>Grantet Qeveritare</i>	1973	11,967,308	1,380,376	481,035	-	3,244,613	17,073,332
<i>Të hyrat vetanake</i>		58,100	834,826	12,780	530,043	1,028,654	2,464,403
<i>Financimi nga Huamarrja</i>		-	183,681	-	-	7,399	191,080
	Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të Komunës së Mitrovicës për vitin 2020-2022						
	Stafi	Paga dhe meditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Subvencio ne dhe transfere	Shpenzime kapitale	Totali
<i>Shpenzimet totale komunale</i>	1992	13,920,938	2,668,883	493,815	530,043	4,501,683	22,115,362
<i>Grantet Qeveritare</i>	1973	13,762,252	1,852,048	477,201	-	3,354,500	19,446,001
<i>Të hyrat vetanake</i>	0	57,800	816,835	16,614	461,543	1,147,183	2,499,975
<i>Financimi nga Huamarrja</i>	19	100,886	-	-	68,500	-	169,386

Tabela 1. Planifikimi i buxhetit për vitet 2019 dhe 2020.

Nga tabelat buxhetore shihet se Granti Qeveritar në vitin 2019 përbente 86.5% të buxhetit total të Komunës derisa në vitin 2020 ishte 87.5%, një rritje prej 1 pikë të përqindjes. Pagat dhe medijtjet në vitin 2019 përbënin 61% të totalit të buxhetit derisa në vitin 2020 kjo arrinte në 62.9%. Shpenzimet kapitale në vitin 2019 përbënin 21.7% të buxhetit derisa në vitin 2020 kishte një rënie për më shumë se një pikë të përqindjes në 20.4%. Mallrat dhe shërbimet ishin përafërsisht të njëjta si në vitin 2019 ashtu edhe në vitin 2020, 12.2 respektivisht 12.1%.

Kritja e buxhetit fillestar gjatë vitit 2019 ishte kryesisht si rezultat i donacioneve të jashtme, të hyrave vetanake, huamarrjes, donacioneve të brendshme si dhe rezervave shtetërore të ndara nga Ministria e Financave.¹⁷

Gjatë viti 2020 buxheti fillestar ishte rritur si rezultat i huamarrjes, donacioneve, vendimit të qeverisë Nr.01/23 të datës 13.08.2020, rezervave shtetërore si dhe rezervave të cilat ishin zvogëluar për 1,579,278 euro.¹⁸

Në përqindje ndarja e buxhetit duket si në tabelën e mëposhtme:

	Shpenzime totale komunale (%)	
	2019	2020
<i>Paga dhe medijtje</i>	61.0%	62.9%
<i>Mallra dhe shërbime</i>	12.2%	12.1%
<i>Shpenzime komunale</i>	2.5%	2.2%
<i>Subvencione dhe transfere</i>	2.7%	2.4%
<i>Shpenzime kapitale</i>	21.7%	20.4%

Tabela 2. Ndarja e buxhetit në përqindje.

¹⁷ Zyra Kombëtare e Auditimit, [Raporti-i-auditimit-K.Mitrovices-2019.pdf](#) (rks-gov.net), [RaportiAuditimit \(zka-rks.org\)](#)

¹⁸ Ibid

Të hyrat vetanake gjatë vitit 2020 ishin për 538,138.00 euro më pak se viti paraprak apo realizim më i dobët për 23%.¹⁹ Një ndër arsyet e realizimit më të dobët ishte si pasojë e drejtpërdrejtë e pandemisë Covid19.

Se si dhe sa është shpenzuar buxheti i komunës sipas kategorive ekonomike për vitin 2019 dhe 2020 tregon tabela në faqen pasuese:

¹⁹ Ibid

Përshkrimi	Buxheti fillestar 2019	Buxheti fillestar 2020	Buxheti final 2019	Buxheti final 2020	Realizimi 2019	Realizimi 2020
<i>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</i>	19,728,815	22,115,359	20,282,112	23,393,842	19,555,066	21,203,738
<i>Pagat dhe Meditjet</i>	12,025,408	12,165,604	12,045,186	12,249,891	11,885,268	12,187,045
<i>Mallrat dhe Shërbimet</i>	2,398,883	2,668,883	2,295,225	4,098,120	2,072,726	3,338,650
<i>Komunalitë</i>	493,815	493,815	493,815	481,484	482,100	382,851
<i>Subvencionet dhe Transferet</i>	530,043	530,043	570,724	1,036,608	531,282	718,371
<i>Investimet Kapitale</i>	4,280,666	4,501,683	4,877,162	5,351,685	4,583,690	4,576,821

Tabela 3. Shpenzimet e buxhetit për vitin 2019 dhe 2020.

Në përgjithësi realizimi i buxhetit të planifikuar ka shkuar mirë edhe sipas kategorive ekonomike. Këtu duhet potencuar se gjatë viti 2020 pandemia Covid19 kishte një efekt të përgjithshëm në të gjitha fushat e jetës dhe ka ndikuar që të rriten shpenzimet te mallrat dhe shërbimet si dhe të subvencionet dhe transferet.

Gjatë vitit 2020, komuna e Mitrovicës së Jugut kishte shpenzuar 682,158 euro për menaxhimin e pandemisë Covid19. Këto mjete ishin shpërndarë në kategoritë paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime si dhe subvencione dhe transfere.

Raportet e ZKA-s për vitin 2019 dhe 2020 në përgjithësi kanë qenë pozitive sa i përket shpenzimit të buxhetit të komunës me disa vërejtje/rekomandime të cilat komuna ka pasur kohë të ndërmarrë masa për përmirësimin e tyre sidomos atyre të vitit 2019 për të cilat ZKA në raportin e vitit 2020 tregon se a janë marra masa në tejkalimin e atyre problemeve.

Transparenca Financiare

Sa i përket transparencës financiare Komuna e Mitrovicës gjatë vitit 2019 dhe 2020 llogaritet në grupin e komunave me transparencë të lartë financiare. Derisa në vitin 2019 ishte e renditur në vendin e 8-të sa i përket transparencës financiare në vitin 2020 ishte përmirësuar dhe ishte në vendin e 3-të.²⁰

Gjithashtu sa i përket buxhetimit gjinor komuna e Mitrovicës ka përmbushur kriteret si në vitin 2019 ashtu edhe në vitin 2020.

Dëgjimet buxhetore janë mbajtur ashtu siç parashihet me

²⁰Instituti GAP, Indeksi I Transparencës Buxhetore të Komunave, https://www.institutigap.org/documents/41931_Indeksi%20i%20Transparenc%C3%ABs%20Buxhetore%202020.pdf, Tetor 2021.

ligji. Qasjes në dokumente publike gjithashtu komuna i'u është përgjigjur ashtu siç e parasheh ligji.

Opinionet e qytetarëve dhe zyrtarëve komunal

Në bashkëbisedim me qytetarët e Mitrovicës ata kanë ngritur disa çështje që sipas tyre janë problematike dhe se Komuna e Mitrovicës duhet të punoj më shumë në sanimin e tyre. Problemet kryesore që qytetarët përmendin janë siguria në shkolla, mungesa e çerdheve publike, nevojë për ndriçim në disa rrugë, rregullimi i trotuareve si dhe parkingjet në qytetin e Mitrovicës apo edhe mungesa e parqeve. Ka edhe kërkesa konkrete si ndërtimi i sallës sportive në shkollën Abdullah Shabani si dhe përfundimi i hartave zonale. Ka qytetarë që vlerësojnë se investimet kapitale janë bërë sipas nevojës dhe sipas prioriteteve dhe mundësive buxhetore të komunës.

Çështjet e ngritura janë çështje që vazhdojnë të dominojnë kërkesat lokale por njëkohësisht janë çështje që vazhdimisht investohet nga komuna por për shkak të buxhetit të limituar të komunës si dhe prioriteteve që vendosë Komuna ato nuk arrijnë të përfundohen dhe secilin vit duhet investuar.

Sa i përket administratës bashkëbiseduesit vlerësojnë se administrata nuk është e politizuar, gjithashtu drejtorët e shkollave sipas tyre janë të partive të ndryshme që në shumë komuna tjera nuk është rasti i njëjtë.

Në intervistat e zhvilluara me disa anëtar të kuvendit dhe zyrtarët komunalë në Mitrovicë kemi marrë përshtypjet e tyre rreth funksionimit të administratës si dhe sfidave që përballen zyrtarët në Komunë por edhe qytetarët e Komunës së Mitrovicës së Jugut në Përgjithësi.

Një ndër çështjet e ngritura është kërkesa për paga më të larta për zyrtarët komunal pasi që pagat e tanishme sipas

tyre janë të ulta. Nëse e shohim nga planifikimi buxhetorë del se 74 punëtorë të administratës dhe personelit për paga dhe meditje janë planifikuar 392,446.00 euro, që i bie se paga mesatare e tyre është 442 euro (nuk duhet harruar se këtu janë llogaritur edhe meditjet). Në përgjithësi gjatë bisedimeve me zyrtarë komunal është theksuar nevoja e futjes së teknologjisë informative si në kryerjen e punëve të brendshme ne Komunë ashtu edhe në raport me qytetarët. Shembulli konkret që u përmend ishte aplikimi për mbështetjen e atyre që kanë pasur COVID-19, ku ata fizikisht është dashur të aplikojnë për përfitimin e atyre mjeteve financiare. Mungesa e mundësisë së aplikimit si dhe rimbursimit online ka rrezikuar edhe stafin e Komunës si dhe vetë aplikuesit gjatë kohës së aplikimit pasi që kontakti i drejtëpërdrejtë pa pasur dijeni nëse personat që kanë aplikuar e kanë kaluar apo nuk e kanë kaluar covidin.

Komuna me një rast ka instaluar dy E-kioska ku qytetarët kanë mundur ti tërheqin disa dokumente të nevojshme, por sipas informatave nga të intervistuarit këto E-kioska ka kohë të gjatë që nuk janë funksionale, njëra është dëmtuar nga njerëz të pandërgjegjshëm përderisa tjetra që gjendet te Komuna është jashtë funksionit për arsye teknike.

Me rastin e planifikimit buxhetor gjithnjë sipas zyrtarëve komunal të intervistuar shihet një mungesë e njohurive dhe jo-kompetencë e disa drejtorëve (staf politik) që si rrjedhojë ka edhe planifikimin e dobët apo në raste tjera intervenimin e atyre zyrtarëve që kuptojnë procedure dhe rëndësinë e planifikimit buxhetor në përmirësimin e kolegëve të tyre. Ky pohim gjen mbështetje edhe të raporti i ZKA-së ku rekomandim i vazhdueshëm gjatë vitit 2019 dhe 2020 është planifikimi i mirë buxhetor karshi obligimeve në mënyrë që të mos ndodhë që obligimet të tërhiqen përmes përmbaruesit.

Dëgjimet publike sa i përket buxhetit kryhen sipas ligjit, lajmërimi bëhet me kohë por si në shumicën e komunave

tjera pjesëmarrja e qytetarëve është e vogël. Pjesëmarrja qytetare jo vetëm në Mitrovicë por gati se në të gjitha komunat tjera vazhdon të jetë një problem i cili për shumë vite ende nuk ka gjetur një zgjidhje.

Zyra Kombëtare e Auditimit

Përderisa vlerësimet e qytetarëve dhe mendimet e zyrtarëve komunal mund të jenë subjektive, raporti i ZKA është një raport zyrtarë profesional, të gjeturat e të cilit duhet të merren parasysh edhe nga zyrtarët komunal.

ZKA ka gjetur se buxheti për vitin 2019 është shpenzuar në masen 96.4% derisa në vitin 2020 ka rënë në 90.6%. Është interesant të potencohet se buxheti fillestar si për vitin 2019 ashtu edhe për vitin 2020 ka qenë më i ulët se buxheti final dhe përkundër rritjes së buxhetit ai nuk është shpenzuar në tërësi. Buxheti final i vitit 2020 kishte një rritje prej 13.3% në krahasim me vitin paraprak.

	2019	2020
<i>Buxheti fillestar</i>	19,728,815	22,115,359
<i>Buxheti final</i>	20,282,112	23,393,842
<i>realizimi</i>	19,555,066	21,203,738
<i>Realizimi në %</i>	96.4%	90.6%

Tabela 4. Buxheti i Komunës për vitin 2019 dhe 2020.

Sa i përket të gjeturave të ZKA për vitin 2019 dhe 2020 ato ndahen në disa grupe.

Për vitin 2019, auditori kishte dhënë 20 rekomandime. Nga këto rekomandime të bëra ne vitin 2019, komuna e Mitrovicës së Jugut kishte zbatuar 13, ndërsa 2 ishin në proces të zbatimit, 4 nuk ishin adresuar fare dhe një ishte

mbyllur.²¹

Një rekomandim i rëndësishëm nga ZKA bërë në vitin 2019 lidhur me shfrytëzimin e pronave të komunës nga persona privat apo juridik që të rikthehen në kontroll të komunës apo të ripërtrihen kontratat për të rritur të hyrat e komunës edhe në vitin 2020 nuk ka filluar së zbatuari.

Gjithashtu rekomandimi për nënshkrimin e kontratave në përputhje me buxhetin e aprovuar nuk ka filluar së zbatuari.

Të dy këto rekomandime i kushtojnë humbje financiare Komunës së Mitrovicës prandaj do të duhet të ishin ndër të parat që komuna do të duhej të intervenonte. Këto dy rekomandime të rëndësishme janë përsëritur edhe në raportin e ZKA-s për vitin 2020.

Gjithashtu një problem i vazhdueshëm këto dy vite mbetet mos-planifikimi adekuat i buxhetit në raport me obligimet që shpie deri të mos-pagesa me kohë e obligimeve e cila rezulton me pagimin e obligimeve përmes përmbaruesve.²² Tërheqja e mjeteve përmes përmbaruesve i kushton mjete shtesë komunës së Mitrovicës që me një planifikim të mirë buxhetor do të mundë të evitoheshin këto humbje.

²¹ Zyra Kombëtare e Auditimit, [Raporti-i-auditimit-K.Mitrovices-2019.pdf \(rks-gov.net\)](#), [RaportiAuditimit \(zka-rks.org\)](#)

²² Zyra Kombëtare e Auditimit, [Raporti-i-auditimit-K.Mitrovices-2019.pdf \(rks-gov.net\)](#), [RaportiAuditimit \(zka-rks.org\)](#)

Rekomandimet

Duke marrë parasysh të gjitha të dhënat e mbledhura nga terreni në bashkëbisedim me zyrtarë komunal, me qytetarë si dhe raportet zyrtare të institucioneve mbikëqyrëse shihet se në Komunën e Mitrovicës së Jugut ka nevojë për ngritjen e kapaciteteve të administratës komunale. Kjo sidomos bie në sy nëse shohim raportin e fundit të thesarit nga Ministria e Financave i cili tërheq vërejtjen Komunes së Mitrovicës për tejkalimet buxhetore dhe keq menaxhim të financave.²³ Pasi që ky raport është i vitit 2021 nuk do të jetë pjesë e këtij raporti por do të merret parasysh për të nxjerrë rekomandime të nevojshme që një gjë e tillë të mos ndodhë në të ardhmen. Duhet rikujtuar se një situatë e tillë ka ardhur si pasojë e keq menaxhimit financiar që nuk lidhet domosdoshmërisht me ndërmarrjen e ndonjë reforme të caktuar. Rekomandimet e mëposhtme ndihmojnë në ngritjen e performancës së administratës komunale si rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje e cila do të rezultojnë me ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët.

Dixhitalizimi - Edhe në biseda me zyrtarë komunal u shpreh nevoja e digjitalizimit apo përdorimit sa më të gjerë të teknologjisë informative dhe kjo rrjedhimisht sjell edhe nevojën e trajnimit të administratës. Këto dy procese do të duhej të zhvilloheshin paralelisht. Përfituesit më të mëdhenj të futjes së teknologjisë informative do të ishin vetë zyrtarët komunal por edhe qytetarët e Komunes së Mitrovicës. Përmes dixhitalizimit duhet krijuar mundësinë qytetarëve që të mund të marrin shërbime më të shpejta dhe në shumë raste pa praninë e tyre fizike ne objektin e komunës si për shembull aplikimi online për një numër dokumentesh të nevojshme që mund të aplikohet me teknologjinë e

²³ Portale të ndryshme, <https://botapress.info/zyrtare-qeveria-kurti-falimenton-komunen-e-mitrovices-dokument/>, <https://www.kosovari.press/ekskluzive-falimenton-mitrovica-e-konfirmon-edhe-qeveria/>

tanishme informative.

Rekomandimet e ZKA-së në dy vitet e fundit tregojnë që stafi komunal nuk po arrijnë që të përgatisë buxhetin komunal në pajtueshmëri me obligimet që duhet kryer dhe si rrjedhojë mjete të shumta financiare po tërhiqen nga përmbaruesit që shkaktojnë humbje të paplanifikuara si pasojë e keq-menaxhimit.

Moduli për funksionimin e administratës komunale si dhe për përgatitjen e buxhetit komunal

- Nga bashkëbisedimi me zyrtarë komunal por duke shikuar edhe raportin e zyrës kombëtare të auditimit shihet se Komuna e Mitrovicës ka problem me përgatitjen e buxhetit komunal që si rrjedhojë ka edhe tërheqjen e mjeteve nga buxheti komunal nga ana e përmbaruesve. Për të tejkaluar këtë sfidë rekomandohet krijimi i një moduli të veçantë lidhur me funksionimin e administratës publike në nivelin lokal si dhe moduli për përgatitjen e buxhetit të komunës. Ky modul duhet të jetë i domosdoshëm sidomos për një pjesë të stafit dhe në veçanti stafit politik i cili udhëheq me drejtoritë e ndryshme të komunës. Moduli si i tillë duhet të jetë i detyrueshëm me rastin e marrjes së detyrës dhe ata që nuk e kalojnë nuk duhet lejuar të marrin pozita udhëheqëse në administratë.

Matja e përformancës - Stafi i administratës komunale bënë një punë të vazhdueshme e cila herë vlerësohet në mënyrë të drejtë e herë në mënyrë të padrejtë si nga udhëheqësit e brendshëm në komunë ashtu edhe nga qytetarët që marrin shërbime. Në mënyrë që të përmirësohet niveli i shërbimeve që ofrohet duhet të krijohet një mekanizëm i brendshëm për matjen e përformancës. Ky mekanizëm do të duhej që në bazë të të dhënave të matshme të mat përformancën e drejtorive si dhe të secilit punëtorë të administratës.

Pjesëmarrja në dëgjime publike – Përkundër punës së mirë që bën komuna me rastin e dëgjimeve publike në planifikimin e buxhetit, pjesëmarrja e qytetarëve është e ulët. Komuna duhet menduar forma tjera për të rritur pjesëmarrjen qytetare në këto ndëgjime publike. Gjetja e formave për të stimuluar qytetarët që të marrin pjesë në dëgjime publike ku vendoset për prioritet e investimeve komunale do të ndikonte në rritjen e përgjegjësisë të zyrtarëve komunal si dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në politikbërje. Rritja e transparencës, llogaridhënja, bashkërendimi i prioriteteve, informimi për tavanet buxhetore, informimi për investimet kapitale dhe avokimi për nevojat në komunitet janë disa nga përfitimet kryesore që qytetarët mund ti kenë nëse marrin pjesë në dëgjime publike.

Lista e publikimeve

Interesi Publik

- #1 Sejdiu, Dardan dhe Kastriot Jahaj. Janar 2013. ‘Taksa’ e fshehur: pse kosovarët paguajnë më shumë?
- #2 Gashi, Drilon and Shoghi Emerson. Maj 2013. Klasë në vete: Patronazhi dhe ndikimi i tij në mobilitetin shoqëror në Kosovë
- #3 Sutaj, Visar and Leon Malazogu. Janar 2013. Le të ngrihet shoqëria civile e vërtetë: Roli i shoqatave me anëtarësi në formësimin e vendimmarrjes në shërbim të interesit publik
- #4 Miftari, Naser. Shtator 2013. Sfida e konsolidimit – Fuqizimi i pavarësisë së institucioneve të medias në Kosovë
- #5 Ardiana Gashi dhe Artane Rizvanolli; Me kontribut nga Natalya Wallin, Rezarta Delibashzade dhe Ngadhnjim Halilaj. 25 shkurt 2015. Sa kushton patriarkati?
- #6 Rezarta Delibashzade, Laura Flemming, Ramadan Klisurica, Agon Maliqi dhe Rina Abazi. 11 Nëntor 2015 Rëndësia e grupeve të interesit: Praktikat, rastet studimore dhe mësimet e nxjerra
- #7 Dukagjin Pupovci dhe Gersi Gashi. Nëntor, 2015 Reformimi i Universiteti të Prishtinës – mission i mundur?
- #8 Leon Malzogu dhe Bernard Nikaj; Me kontribut nga Gulliver Brady. Nëntor, 2016. Nxitje për llogaridhënie dhe performancë më të mirë në arsimin e lartë
- #9 Jehona Serhati, me kontribut redaktues nga Abby Riley. Janar, 2017. Stimujt për reformë: Rritja e mundësive për nxënësit/et dhe të diplomuarit/at e AAP-së në tregun e punës
- #10 Isuf Zejna. Korrik 2017. Zhvillimi i turizmit përmes politikave dhe legjisllacionit efikas.
- #11 Visar Sutaj. Tetor 2017. Sa të pavarura janë autoritetet rregullatore në Kosovë?
- #12 Linda Abazi Morina dhe Rezarta Delibashzade. Me contribute nga Ajete Kërqeli dhe Valëza Zogiani. Nëntor 2017. Joaktiviteti i grave në tregun e punës.
-

#13 Ajete Kërqeli. Me kontribute nga Ardiana Gashi. Dhjetor 2017. Ndryshimi i paradigmës – Barazi përmes lejes prindërore.

#14 Vjollca Krasniqi. Mars 2018. Gjendja e vullnetarizmit në Kosovë: Sfidat dhe perspektivat.

#15 Xhavit Rexhaj. Me kontribut nga Rasim Alija. Prill 2018. Funksionimi i Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës: Analizë e punës dhe vendimeve.

#16 Krenar Gashi dhe Gersi Gashi. Rishikuar nga Dr. Besnik Pula. Nëntor 2018. Zanafilla plus dhjetë: Analizë e dekadës së pare të shtetësisë së Kosovës.

#17 Aliriza Arenliu dhe Gersi Gashi, me contribute nga Elmedina Bajgora. Mars 2019. Matja dhe vlerësimi i politikave të riintegrit: Politika të bazuara në dëshmi për të siguruar riintegrim të qëndrueshëm.

#18 Alba Boshnjaku dhe David JJ Ryan. Qershor 2019. Parental Rights in Kosovo: Legal analysis regarding the proposed amendments to maternity and parental leave (vetëm në anglisht).

#19 Kaltrina Temaj. Rishikuar nga: Valëza Zogjani. Shtator 2019. Inclusion of Women in decision-making and local governance in Kosovo (vetëm në gjuhën angleze).

#20 Albert Krasniqi. Dhjetor 2020. Analizë mbi veprimtarinë e Kuvendit të Kosovës në periudhën 2019-2020.

#21 Judita Krasniqi. Janar 2021. Kush e paguan çmimin më të lartë? Ndikimi i Covid-19 në punësimin e grave në Kosovë.

Këto punime dhe të tjera të publikuara nga instituti D4D, mund t'i lexoni në vegëzën: www.d4d-ks.org/punime.

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

352(496.51-2)(047)

Administrata Komunale në Mitrovicën e Jugut: Reforma si mekanizëm i zhvillimit/ punim i përgatitur nga Instituti Demokraci për Zhvillim. - Prishtinë : Demokraci për Zhvillim, 2021. - 33 f. : ilustr. ; 22 cm.

Qeverisja lokale -- Raporte -- Mitrovicë e Jugut (Kosovë)

Financa publike – Raporte -- Mitrovicë e Jugut (Kosovë)

ISBN 978-9951-823-18-0

Aleph [000099216]

Instituti Demokracia për Zhvillim (D4D) është themeluar në prill të vitit 2010 nga një grup i analistëve që po brengoseshin gjithnjë e më shumë që procesi i shtetndërtimit e kishte lënë anash demokracinë.

Vizioni i D4D-së është të promovojë një qytetari aktive dhe të arsimuar, e cila merr pjesë plotësisht në hapësirën publike dhe e përdor arenën publike për përfaqësim dhe vendim-marrje për të diskutuar dhe ndërtuar konsensus për shpërndarjen e resurseve që janë efikase, të shpejta, afatgjate dhe që sjellin zhvillim të barabartë.

D4D ndikon në politikat specifike, promovon një qasje ndër-sektoriale për zgjidhjen e problemeve dhe trajton rutinën institucionale të vendimmarrjes duke rekomanduar përmirësime në rritje dhe operon me efektivitet maksimal në mënyrë që të promovojë plotësisht stabilizimin e Kosovës dhe zhvillimin demokratik.

Për më shumë informata rreth aktiviteteve të D4D-së, ju lutemi vizitoni faqen tonë elektronike: www.d4d-ks.org

ISBN 978-9951-823-18-0



9 789951 823180